



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, Trupi Gjykes më 28 gusht rrëzoi kërkesën e Mbrojtjes së Selimit për të përjashtuar disa prova lidhur me dëshminë e një dëshmitari. Trupi Gjykes e rrëzoi për arsye se Prokuroria dhe Mbrojtësi i Viktimave konfirmuan se nuk synonin t'i bënin pyetje dëshmitarit për aspektet për të cilat shqetësohej Mbrojtja.

Këtë javë, dy dëshmitarë të Prokurorisë dhanë dëshmi në Gjykatë në këtë çështje gjyqësore. Sipas përmbledhjes së dorëzuar nga Prokuroria, dëshmitari i parë, Imer Imeri, u rrëmbye nga ushtarë të maskuar të UÇK-së në Shqipëri, sepse përkrahte Ibrahim Rugovën dhe LDK-në. Sipas përmbledhjes, z. Imeri u mbajt fillimisht i ndaluar në Shqipëri dhe më pas, rreth mesit të qershorit 1999, u transferua në Prizren, në Kosovë. Dëshmitari i dytë, Rrustem Tetaj, është ish-oficer i UÇK-së që kishte poste të ndryshme në zonën operative të Dukagjinit gjatë verës së 1998-ës.

Deri tani, 84 dëshmitarë kanë dëshmuar në këtë gjykim, krahas dëshmimeve të dëshmitarëve që janë pranuar vetëm me shkrim.

Seanca tjetër në këtë çështje gjyqësore, është caktuar për të hënë, 16 shtator, në orën 9 të mëngjesit.

Më 3 shtator, Kryetare Trendafilova caktoi Panelin e Gjykatës së Apelit për të shqyrtuar njoftimin për apel të Pjetër Shalës kundër aktgjyimit të shqiptuar në këtë çështje. Paneli i Apelit përbëhet prej gjykatësve Mishelë Pikar, Kai Ambos dhe Nina Jorgensen.

Më 4 shtator, Kryegjykatësja e Panelit të Apelit caktoi mbajtjen e një konference para apelit për të premten, 20 shtator 2024, në orën 10:00. Gjatë seancës pritet që palët të bëjnë parashtrime dhe Paneli do të kërkojë informacion të përditësuar mbi ecurinë e përkthimit të Aktgjyimit në gjuhën shqipe.

Më 16 korrik 2024, z. Shala u shpall fajtor për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme dhe u dënua me 18 vjet burgim, ku llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim. Ky është apeli i dytë para Dhomave të Specializuara që lidhet me krime lufte.

Më 3 shtator, Kryetare Trendafilova caktoi Trupin Gjykes I në çështjen *Sabit Januzi, Ismet Bahtijari dhe Haxhi Shala*. Trupi Gjykes përbëhet nga gjykatësit Roland Dekers, Mapi Feld-Folia, Zhilber Biti, dhe Vladimir Mikula si gjykatës rezervë. Vendimi i Kryetares erdhi në vijim të njoftimit nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake se dosja do të ishte gatë për t'i kaluar trupit gjykes më 4 shtator 2024.





Më 3 shtator, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rrëzoi kërkesën e Haxhi Shalës për të urdhëruar përkthimin në shqipe të të gjitha dokumenteve në dosjen e kësaj çështje. Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstatoi se të akuzuarit kishin mënyra të mjaftueshme për të kuptuar çështjen dhe se Mbrojtja nuk demonstroi se sistemi aktual për përkthimin e provave është i papërshtatshëm. Gjykatësja e Procedurës Paraprake vlerësoi se miratimi i kërkesës do të vononte më tej kalimin e çështjes për gjykim. Gjithashtu, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujtoi Mbrojtjen se sistemi i ndihmës juridike përfshin edhe fonde për ekipet e Mbrojtjes për përkthime me gojë e me shkrim.

Dhomat e Specializuara i përkthejnë të gjitha dokumentet dhe parashtrimet e protokolluara publike në tri gjuhët e Gjykatës, shqipe, serbishte dhe anglishte, sa më shpejt që është e mundshme. Duke pasur parasysh kërkesën që dokumentet të përkthehen sipas standardeve më të larta, mund të nevojitet njëfarë kohe për përfundimin e përkthimeve në shqipe dhe serbishte, në çështjet ku gjuha e punës është anglishtja.

Për t'u dhënë të akuzuarve dokumentet më të rëndësishme në gjuhën e tyre sa më shpejt që të jetë e mundur, Rregullorja e Procedurës dhe Provave parashikon që dokumenteve të caktuara t'u jepet përparësi në përkthim. Për shembull, aktakuza duhet t'i jepet të akuzuarit në një gjuhë që e kupton.

Më 2 dhe 3 shtator 2024, u bënë publike vendimet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake të datave 28 prill, 3 maj dhe 25 shtator 2023 për autorizimin e kontrollimeve dhe sekuestrimeve lidhur me Sabit Januzin dhe Ismet Bahtjarin. Këto mund të gjenden në faqen e internetit të DHSK-së.

